

Jetëshkrimi Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve

Miklovan Kopani ka lindur më 1975, është i martuar dhe ka një fëmijë. Kopani është emëruar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve më është 16.07.2016. Emërimi i Kopani në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve ka ardhur si rezultat e një përvoje të gjatë në shërbimin publik, përfshirë dhe institucione të sigurisë kombëtare.

Gjatë viteve 1993-1997, ka përfunduar studimet universitare për Drejtësi, pranë Universitetit Tiranë.

Prej vitit 2013 deri në korrik të këtij viti, ka qenë Drejtor i Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve Kushtetuese dhe të Pavarura, që informojnë dhe raportojnë pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në vitin 2002 deri në vitin 2012, ka qenë i punësuar në Shërbimin Informativ të Shtetit.

Në vitin 1998-2002 ka punuar si jurist në “MEICO” (Military Export Import Company), ndërmarrje shtetërore në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë.